




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 18223/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtës kundër të pandehurit Dilaver Kryeziu nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 5,6 par. 1 dhe 2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 si dhe neni 9 te Ligjit nr. 04/L-050 te Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave për te gjithë personat zyrtar,e në bazë të nenit 73,74,195, 199, të LMK me dt. 17.10.2012 merr këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI : Dilaver Sabit Kryeziu, i lindur më 01.05.1957 ne Rogaqic K. Kamenicë, tani më vendbanim në Prishtinë rr. Gazmend Zajmi nr. 97 A, me profesion Profesor i korografis ,i gjendjes së mesme ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse i pandehuri në cilësinë zyrtarit te lartë publik, Drejtor i Ansambilit Kombëtare te këngëve dhe valle “Shota” ne Ministrin e Kulturës Rinis dhe Sportit, nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë,i cili behtë me deklarimin e rregullt vjetor deri me datën 31.03.2012 të çdo viti kalendarik në Agjensionit Kundër Korrupsionit Me këtë ka kryer vepër kundërvajtës nga 5,6 par. 1 dhe 2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 si dhe neni 9 te Ligjit nr. 04/L-050 te Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave për te gjithë personat zyrtar, andaj për këtë:

D E N O H E T

Me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) EURO. Gjorbën e shqiptuar i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktvendim të merr formën e prerë në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së. No.1000-4300-7000-0518 Pagesa bëhet në ndonjëren agjenci për mbledhjen e të hyrave –bankë,përmes urdhërpagesës të plotësuar nga Gjykata. Nëse brenda afatit të caktuar i pandehuri nuk e paguan gjobën e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 dite duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) EURO në një ditë burgu.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur kurse në emër të paushallit i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej 5 (pesë) EURO në afat të njëjtë sikurse gjobën në shërbimin e arkës së Gjykatës.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit , parashtroi kërkesën nr. 18223/2012 të dt 22.05.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtës kundër të pandehurit së përmendur më lartë dhe për kundërvajtjen e lartcekur, ku është marrë Konkluzion. Gjatë procedurës u dëgjua i pandehuri i cili në deklaratën e tij pohoj se sa i përket mbushjes se formularit për deklarimin pasurisë ka ndodh për arsye se prej dt.07.04.2012 kam qenë i angazhuar për mbajtjen e koncerteve në Shqipëri, dhe kam mënd se afati për mbushjen dhe dorëzimin e formularit fundi muajin prill dhe pas përfundimit te këtyre koncerteve kam ardh e kam mbush formularin me dt. 12.04.2012 ku kam mëndu se prilli është afati për me mbush këtë formularin ku unë në prill e kam mbush dhe e kam dergu në agjensionin , ku jam informuar nga agjensioni se afati ka qenë deri me 31 mars. për me i derzu formularin. në fund kërkoj falje qe nuk e kam mbush me kohë formularin dhe me rastin e marrjes se vendimti pasi qe profesioni ynë është specifik, dhe kam pas disa shqetësime mediale te cilët me kanë shqetësuar shumë, ku ma shqiptoni një dënim ma te butë por kundërvajtjen e pranoj.

Gjyqtari pasi që administroj provat dhe të provuarit e kësaj çështje, në mënyrë të drejt dhe të plotë vërtetoj gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, andaj për këtë e shpalli fajtor dhe e dënoi si në diapozitiv të këtij aktvendimi Me rastin e shqiptimit të dënimit Gjyqtari mori për bazë të gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet e posaçërisht nëshën e kundërvajtjes së bërë, andaj ia shqiptoj këtë lloj të dënimit duke konsideruar se vetëm me këtë do të arrihet efekti pozitiv dhe se në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e veprave të këtilla dhe të ngjashme. andaj u vendos si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
GJYQTARI PËR KUNDËRVAJTJE

Fatmir Behrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala dhe ushtruesi i kërkesës ankesë mund ti ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë,në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi nëpërmjet të kësaj Gjykate dhe pa taksa.